



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA**

**KOMUNA VUSHTRRI**  
**OPSTINA VUCITRN**

**PROCESVERBAL**

**nga mbledhja e -V-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më  
16 korrik 2020 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:15.**

Në mbledhje ishin të pranishëm: Nasuf Aliu (kryesues), Melihate Basholli-Latifi, Ymer Haradinaj, Shkëlzen Feka, Teuta Aruçi Shartari dhe Nezir Klinaku (anëtarë të KPF -së).

Mungoi: Shpëtim Zhegrova.

*Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë: Xhafer Tahiri, kryetar i komunës edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësues nga sekretaria e kuvendit.*

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së, i cili konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Aliu tha se na kanë ardhur edhe disa propozime për t'i futur në pika të ndryshme:

- Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2020;
- Shqyrtimi i kërkesës së Sindikatës të Shërbyesve Civilë të Kosovës-dega në Vushtrri lidhur me pagesën e shujtës ditore.

**Gresa Muli, anëtare e KPF-së** – theksoi se në cilësinë e grupit të grave të kuvendit të komunës, së bashku me Teuta Aruçi Shartari dhe Fjolla Ujkani (Komisioni parlamentar për të Drejtat e Njeriut të Kuvendit të Kosovës) kemi vizituar “Shoqatën Down (Daune) Syndrome Kosova – DSK”, dega në Mitrovicë dhe e kemi pa të arsyeshme që ta propozojmë në kuvend një shumë të mjeteve financiare për t’iu ndihmuar, pasi që kjo kohë e pandemisë ua ka stagnuar aktivitetet për shkak të mjeteve financiare. Në këtë shoqatë ka persona edhe nga Komuna e Vushtrrisë. Prandaj, kërkoj që brenda mundësive komuna jonë t’iu ndajë një shumë të mjeteve financiare për t’iu ndihmuar sado pak, tha ajo.

**Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së** – tha se dëshiron ta plotësojë Gresën në mënyrë që kjo kërkesë të jetë më e fuqishme, e cila kërkesë është e grupit të grave të kuvendit të komunës. Ajo tha se kanë pasur një takim online me grupin e grave të kuvendeve komunale të regjionit, ku këtë takim e ka organizuar kryetarja e “Shoqatës Down (Daune) Syndrome Kosova – DSK”. Ajo tha se nga ky takim u pa e arsyeshme që bashkërisht tri komunat (Vushtrri, Mitrovicë dhe Skënderaj) brenda mundësive ta ndihmojnë financiarisht këtë shoqatë.

Ajo kërkoj që kjo kërkesë të futet në rend të ditës dhe të procedohet për kuvend.

**Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi këtë:**

## R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12 qershor 2020;
2. Shqyrtimi i kalendarit kohor për mbajtje të dëgjimeve buxhetore;
3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2021 **(shqyrtimi i parë)**;
4. Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe raporti i auditimit për vitin 2019;
5. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor (janar – qershor 2020) për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2020;
7. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore;
8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2020;
9. Shqyrtimi i kërkesës së Sindikatës të Shërbyesve Civilë të Kosovës-dega në Vushtrri lidhur me pagesën e shujtës ditore;
10. Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare të “Shoqatës Down (Daune) Syndrome Kosova – DSK”;
11. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 12 qershor 2020.

***Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 12 qershor 2020.***

2. Shqyrtimi i kalendarit kohor për mbajtje të dëgjimeve buxhetore.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së-** tha se kemi pasur një takim konsultativ lidhur me këtë çështje, ku ishte i pranishëm edhe drejtori i financave. Nga ai takim u dakordua që unë si kryesues të angazhohem dhe të shikojë praktikën e komunave tjera se si kanë vepruar me këtë çështje. Pjesa më e madhe e komunave nuk kanë proceduar ende me asnjë aktivitet lidhur me kalendarin e dëgjimeve buxhetore.

Asociacioni i Komunave na ka njoftuar se në disa komuna, KPF-ja është takuar me kryesinë e këshillave të fshatrave, kurse pjesa më e madhe e komunave e kanë vendosur njoftimin në web faqe dhe kanë kërkuar kryesinë e këshillave të fshatrave e lagjeve urbane dhe banorët që brenda një afati të caktuar kohor t’ua sjellin kërkesat e tyre KPF-së apo kryetarit të komunës varësisht se si ka qenë njoftimi, tha Aliu.

Prandaj, bashkërisht do të vendosim për mënyrën se si të procedojmë me këtë çështje.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – deklaroi se mund ta krijojmë një formë në google dhe t’i kërkojmë psh se cilat janë pesë prioritetet për lokalitetin tuaj. Pastaj aty mund të votohet dhe e shohim se cila është përqindja më e madhe e prioritetëve.

Prandaj, qysh të vendosim, e bëjmë një njoftim për media ku i njoftojmë qytetarët se për shkak të pandemisë, dëgjimet buxhetore do të bëhen në këtë formë.

**Melihate Basholli Latifi, anëtare e KPF-së** – ajo kërkoi që kërkesat e qytetarëve të viteve të kaluara të na i sjellin neve si anëtarë të KPF-së dhe ta shohim realizimin apo mosrealizimin e atyre kërkesave. Anëtarët e tjerë nuk e di a dëshirojnë që t'i kenë, por unë individualisht dua t'i shoh ato kërkesa, tha ajo.

Ajo theksoi se është kundër që kërkesat të na i sjellin kryetarët e këshillave të fshatrave, sepse po ua marrim të drejtën shumicës së banorëve të komunës sonë. Prandaj, po pajtohem që të shkohet me metodën online dhe të bëhen sa më shpejt përgatitjet.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së**– lidhur me kërkesat e qytetarëve që kanë dalë nga dëgjimet buxhetore në vitin 2019 , ne të gjithë anëtarët e KPF-së që kemi marrë pjesë në dëgjimet buxhetore i kemi dorëzuar në Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.

**Gresa Muli, anëtare e KPF-së** – tha se ne si anëtarë të KPF-së, zakonisht e dimë se cilat janë kërkesat e qytetarëve që dalin nga dëgjimet buxhetore.

Ajo tha se kërkesat kur të dërgohen në emailin që jepet në njoftim, do të ishte mirë që të bëhet një përmbledhje e atyre kërkesave dhe të na përcjellet neve si anëtarë.

**Xhafer Tahiri, kryetar i komunës** – u shpreh se të gjitha kërkesat do të grumbullohen dhe do të kanë qasje të gjithë anëtarët e KPF-së.

*Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, anëtarët e KPF-së njëzëri u pajtuan që kërkesat e qytetarëve për planifikimin e buxhetit për vitin 2021 të pranohen online (përmes emailit) deri më datën 29 korrik 2020 e pastaj të procedohet në kuvend .*

3. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për tatimin në pronën e paluajshme për vitin 2021 (shqyrtimi i parë).

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa**– tha se në faqen katër e kemi një ndryshim ku janë paraqitur çmimet. Prandaj, për shkak të kësaj kemi marrë vërejtje nga auditori i përgjithshëm, sepse çmimet nuk është dashur të jenë fare, pasi që çmimet i përcakton ministria, kurse ne si komunë vetëm normën tatimore e tatimojmë.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

4. Shqyrtimi i pasqyrave financiare dhe raporti i auditimit për vitin 2019.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

5. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmuor (janar – qershor 2020) për të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

**Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit dhe i KPF-së**– lidhur me këtë pikë, drejtori i financave tregoi për shkak të pandemisë Covid 19 , drejtorja është duke punuar me staf të kufizuar dhe nuk kanë pasur mundësi ta përgatisin raport.

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa**– tha se deri në kuvend, këtë raport do ta përgatisim.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

6. Shqyrtimi i Informatës lidhur me zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës për periudhën janar – qershor 2020.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

7. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë e produkteve ushqimore.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

8. Shqyrtimi i Informatës për gjendjen e sigurisë në Komunën e Vushtrrisë për periudhën janar-qershor 2020.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

9. Shqyrtimi i kërkesës së Sindikatës të Shërbyesve Civilë të Kosovës-dega në Vushtrri lidhur me pagesën e shujtës ditore.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – tha se është një situatë e paqartë, ku Ligji për Shërbyesit Civilë është shfuqizuar nga Ligji për Zyrtarët Publik. Kurse, shujtat punëtorët e arsimit dhe shëndetësisë po i marrin. Prandaj, drejtori i financave duhet të na sqarojë lidhur me këtë se çfarë mund të bëhet. A kemi të drejtë si komunë t’ua paguajmë shujtat ditore shërbyesve civilë?

**Lutfi Gërguri, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa**– tha se nuk kemi të drejtë t’ua paguajmë. Por, është mirë që zyra ligjore të jep një opinion lidhur me këtë.

**Nezir Klinaku, anëtar i KPF-së** – theksoi se para se të dërgohet në kuvend, zyra ligjore ta jep një opinion lidhur me këtë çështje.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që zyra ligjore e komunës të jap mendim profesional (opinion ligjor) lidhur me atë se kuvendi a ka të drejtë të marr vendim për përmbushjen e shpenzimeve për shujtë ditore për shërbyesit civilë.*

10. Shqyrtimi i kërkesës për mbështetje financiare të “Shoqatës Down (Daune) Syndrome Kosova – DSK”.

*Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të sjellet kërkesa me shkrim nga shoqata dhe të procedohet për shqyrtim në Kuvend, në mbledhjen e radhës.*

11. Të ndryshme.

Mbledhja përfundoi në orën **15:20**.

**Faton Behrami**

**Procesmbajtës**



**Nasuf Aliu**

**Kryesues i KK-së dhe i KPF- së**